



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë furnizimi Procedurë për kuotim çmimesh

Në përputhje me Nenin 13 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (Dhjetor 2024)

Data: 14.07.2026

Nr. i Prokurimit: **“BQK 26 060 134”**

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Luan Haradinaj Nr. 2	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: “Furnizim me rroba pune për stafin”
Lloji i prokurimit: Furnizim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): N/A
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës: 12,520.00 euro
Vlera e Parashikuar për pjesën/Lot 1 (Furnizim me uniforma për stafin e administratës): 7,000.00 euro

Vlera e Parashikuar për pjesën/Lot 2 (Furnizim me rroba pune për stafin e departamentit të Parave dhe Marrëdhënieve Bankare): 5,520.00 euro
Procedura është e ndarë në dy pjesë/lotë, dhe ofertuesit janë të lirë të paraqesin ofertë vetëm për njërin lot ose për të dyja lotet, sipas kapaciteteve dhe interesit të tyre.
Ndarja në Pjesë: PO

III INFORMACIONE PËR SHËRBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale furnizimin me rroba pune për stafin e divizionit me para te gatshme si dhe departamentin administratës, sipas kërkesave dhe përshkrimit teknik të BQK-së. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t'u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas</i>	<u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.
	<u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.
	<u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”
	<u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset. Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.

¹ Sipas nenit 32 të Rregullës për prokurimin në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

<i>dorëzimit të ofertës!</i>	<u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium) <u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedure tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohen si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të kësaj Rregulle. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.
<i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i>	<u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. <u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. <u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit. <u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin. <u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata. <u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – <i>Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesa 7, mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i>	<u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 2 (dy) kontrata të natyrës se ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të fundit (2023, 2024 dhe 2025, përfshirë edhe 2026 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontrate). <u>Evidenca 7.</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me Furnizimet e ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (së bashku me dokumentet e kërkuara në formular); <u>Kërkesa 8:</u> Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike për furnizimet e ofruara të cilat garantohej që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. <u>Evidenca 8:</u> Një deklaratë e nënshkruar dhe e vulosur për specifikacionet teknike për furnizimet e ofruara të cilat garantohej që përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. <u>Kërkesa 9:</u> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Katalogët- me specifika teknike, foto dhe detaje e përshkrim të artikujve të ofruar (sipas kërkeses në tabelën e specifikave teknike). <u>Evidenca 9:</u> Kataloget e të gjithë artikujve, të kenë të shënuar qartë produktin e ofruar, ashtu sic është kërkuar në tabelën e specifikave teknike.

V PROCEDURA

V.1 Lloji i procedurës: “Procedure për kuotim çmimesh” (Neni 13 i Rregullës për Prokurimin në BQK)

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” (në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimit në BQK)

VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 17.07.2026, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org .
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 17.07.2026, ora 14:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org .
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave, data: 21.07.2026, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. Luan Haradinaj nr. 2, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave, data: 21.07.2026, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. Luan Haradinaj nr. 2, 10000 Prishtinë.
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): Nuk aplikohet
Kushti i sigurimi të kontratës: Kushti i sigurimi të kontratës (do të kërkohe vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 60 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertave
Dokumentet me pagesë: Jo

VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Luan Haradinaj nr. 2, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org , brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

IX. ADRESA

Rr. Luan Haradinaj nr. 2	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763